



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA  
SKENDERAJ  
Nr. 07-110/09-007201/26  
Data 12-05-2026



**Komuna Skenderaj**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Drejtoria e Arsimit

<b>Data/Date:</b>	12.05.2026
<b>Nga/Od/From</b>	Fjolla Aliu – kryesuese e komisionit për hartimin e Draft-Rregullorës për institucionet edukativo-arsimore në komunën e Skenderajt
<b>Për/Za/To:</b>	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës
<b>CC</b>	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu
<b>Tema/Subjekat/Subject</b>	Raporti për ecurinë e hartimit të Draft-Rregullores për institucionet edukativo-arsimore në komunën e Skenderajt

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Më 24.03.2026, kryetari i komunës, Sami Lushtaku ka emëruar komisionin për hartimin e Draft-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Skenderajt.

### Takimet

Komisioni në bashkëpunim me Zyrën ligjore udhëheqë procesin e hartimit të draftit fillestar dhe siguron që të zbatohen të gjitha procedurat dhe parimet e parashikuara në rregulloret dhe ligjet në fuqi.

### KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik u hap më 08.04.2026 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për këtë draft-plan dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente.

Publikimi në webfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Plani u publikua në këtë link në faqen zyrtare:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/RREGULLORE-PER-INSTIUCIONET-EDUKATIVE-ARSIMORE-TE-KOMUNES-se-Skenderajt15-1.docx>

Në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-DKA.pdf>

## **KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Me datë: 15.04.2026 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë drejtorë të shkollave, mësimdhënës/e, edukatorë/e nga shkollat e komunës së Skenderajt si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund ta gjeni të publikuar në vegëzën:

Diskutim publik mbi "Rregulloren për Arsim në komunën e Skenderajt" - Komuna Skenderaj

Konsultimi publik filloi në orën 13:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori i Arsimit, Kastriot Duraku, i cila në pika të shkurtëra prezantoi përmbajtjen e Draft- Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Skenderajt, e cila ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim, masat dhe procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve, mësimdhënësve dhe personelit tjetër në shkollë (drejtori, zëvendësdrejtori, mësimdhënësi/ja, pedagogu/psikologu, sekretari ose administratori, koordinatori i cilësisë, këshilltari i karrierës, bibliotekari dhe personeli tekniko-shërbyes),.

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm)
<p><b>1. Besart Rrecaj – Sugjeroj që të neni 60 ndërrimi i paralelës të ndryshohet të masat edukative disiplinore për nxënës!</b></p>	<p>Me shumicë votash u vendos që të dispozitat e masave disiplinore për nxënës të bëhen ndryshime, si p.sh ndërrimi i paralelës të hiqet dhe disa masa të ashpërsohen.</p>
<p><b>2. Ajet Ajeti – Propozoj që kodi i veshjes të jetë i njëjtë për të gjithë mësimmshënësit.</b></p>	<p>Këtë propozim e rregulluam bazuar në Rregullorën e komunës për Kodin e Etikës e miratuar nga Kuvendi Komunal.</p>
<p><b>3. Arizona Musa – Të vendoset si pikë e vecantë apo e përmendur kontrata dhe marrëveshja me prindërit për vijimin e fëmijëve në institucion.</b></p>	<p>Ky propozim nga drejtoresha e IP u vendos si dispozitë me shumicë të votave nga të pranishmit pasi që kjo do ta drejtonte edhe më mirë bashkëpunimin e institucionit me prindërit.</p>

Komentet – Janë dhënë gjithsej 3 komente dhe të triat janë pjesë e draft-planit

Tema	Drejtoria	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
<p><u>Draft-Rregullore për institucionet edukativo-arsimore në komunën e Skenderajt,</u></p>	<p>Drejtoria e arsimit</p>	<p>F M T 8 26 34</p>	<p>Salla e Kuvendit 15.04.2026</p>	<p>3 komente  Të 3 komentet janë marrë për bazë</p>	<p>1. <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-DKA.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-DKA.pdf</a></p> <p>2. <u>Diskutim publik mbi "Rregulloren për Arsim në komunën e Skenderajt"</u> <u>Komuna Skenderaj</u></p> <p>3. <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/DKA.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/DKA.pdf</a></p>

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek e-mailat e zyrtarëve.

Komisioni në bashkëpunim me Zyrën Ligjore kanë mbajtur takim dhe kanë verifikuar që disa nga komentet që janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik janë përfshirë në plan dhe janë pjesë e tij.

Meqë faza e konsultimit publik ka përfunduar, atëherë unë si zyrtare përgjegjëse për hartimin e kësaj rregulloreje këtë raport mbi procesin e konsultimit publik do të ja dërgoj kryetarit të komunës dhe me siguri që ky Plan do të dërgohet shpejt për miratim në Kuvendin e Komunës.

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. Vendimi për emërimin e grupit punues
2. Njoftimin publik për konsultimin publik
3. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
4. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

**Fjolla Aliu**

**Kryesuese e komisionit**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPSINA  
SKENDERAJ

Nr. 02-020/01-0010432/26  
No. \_\_\_\_\_  
Data 24.03.2026  
Date \_\_\_\_\_



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe Udhëzimin Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, pas shqyrtimit të Kërkesës nr. 07-020/01-0008467/26, të datës 04.03.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**(Mbi formimin e grupit punues)**

- I. **Formohet grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:**
  1. Fjolla Aliu, kryesuese;
  2. Visar Shabani, anëtar;
  3. Shukri Dervishi, anëtar.
- II. **Detyrë e Grupit Punues** është hartimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Skenderajt, mbajtja e konsultimit publik dhe raportimi me rastin e miratimit në Kuvendin Komunal.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.02-020/01-0009884/26, i datës 18.03.2026.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Arkivit
- DKA-së
- Anëtarëve të Grupit Punues





Republika e Kosovës  
Skenderaj Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Opstina Skenderaj  
Municipality of Assembly

Bazuar në ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr. 110-385, neneve 28 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë:

### Njoftim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Skenderajt.

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 08.04.2026 deri me datën 24.04.2026 ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 15.04.2026, në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 13:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën 24.04.2026 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: [dka.skenderaj@rks-gov.net](mailto:dka.skenderaj@rks-gov.net) dhe [besiana.thaci@rks-gov.net](mailto:besiana.thaci@rks-gov.net).

Për më shumë detaje për Draft-Rregulloren për institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Skenderajt mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Konsultim-publik-Dka.pdf>

Platformën qendrore për Konsultime Publike:

[https://konsultimet.rks-](https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20533&OpenPage=0&ClosedPage=0)

[gov.net/consultations.php?InstitutionID=20533&OpenPage=0&ClosedPage=0](https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20533&OpenPage=0&ClosedPage=0)



Fjolla Aliu

Kryesuese e komisionit

Lista e nënshkrimeve të qytëtarëve pjesmarrës në konsultim publik lidhur me hartimin e rregullorës për institucione edukativo - arsimore

Nr	Emri Mbiemri	Nënshkrimi
1	ANTON ISTOÇU	<i>Anton Istoc</i>
2	Armond Hoti	<i>Armond Hoti</i>
3	ARDI JAKUPI	<i>Ardi Jakupi</i>
4	Shkëndije Idrizi - Mouina	<i>Shkëndije Idrizi</i>
5	Hala Shabani	<i>Hala Shabani</i>
6	Visar Shabani	<i>Visar Shabani</i>
7	Agon Ferizi	<i>Agon Ferizi</i>
8	Salip Ymeri	<i>Salip Ymeri</i>
9	Latmir Hoti	<i>Latmir Hoti</i>
10	Arizona Musa - Vllasa	<i>Arizona Musa</i>
11	Enver Mula	<i>Enver Mula</i>
12	Antigona Maligi	<i>Antigona Maligi</i>
13	Vosni Vepri	<i>Vosni Vepri</i>
14	Albion Ajeti	<i>Albion Ajeti</i>
15	Besjana Gashi	<i>Besjana Gashi</i>
16	Andeta Xani	<i>Andeta Xani</i>
17	Arben Zabelu	<i>Arben Zabelu</i>
18	Bekim Jafaj	<i>Bekim Jafaj</i>
19	Besnik Xani	<i>Besnik Xani</i>
20	Tarik Gecaj	<i>Tarik Gecaj</i>
21	Semir Fazli	<i>Semir Fazli</i>
22	Sheban Lushitaku	<i>Sheban Lushitaku</i>
23	Semir Mula	<i>Semir Mula</i>
24	Mhalil Thaci	<i>Mhalil Thaci</i>
25	Art Ajeti	<i>Art Ajeti</i>
26	ZEQIR KADRIU	<i>Zeqir Kadriu</i>
27	Lejti Hajdari	<i>Lejti Hajdari</i>
28	Murat Gashi	<i>Murat Gashi</i>
29	Afrim Lushitaku	<i>Afrim Lushitaku</i>
30	FATMIR HOTI	<i>Fatmir Hoti</i>
31	HALIT KLABASHI	<i>Halit Klavashi</i>
32	ALI NURA	<i>Ali Nura</i>
33	BESNIK MZIU	<i>Besnik Mziu</i>
34	SHEHRIE RAMA	<i>Shehrië Rama</i>
35		
36		
37		
38		
39		
40		

Datë 15.04.2026